



Në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, me datë 24.11.2022, nxjerr:

VENDIM

1. Aprovohet forma dhe përmbajtja e stemës së Agjencisë konform emërtimit të ri ligjor si Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.
2. Stema e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit përmban shenjën dalluese me figura simbolike, e cila përfaqëson mandatin, territorin dhe ndërlidhjen me traditën, si dhe ngjyrat e Flamurit të Republikës së Kosovës.
3. Obligohen të gjithë nëpunësit e Agjencisë që stemën e re të Agjencisë ta vendosin në të gjitha dokumentet dhe shkresat zyrtare të lëshuara nga Agjencia, duke përfshirë komunikimet përmes shkresave zyrtare dhe elektronike.
4. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, Agjencia do të ndërmarrë veprimet e nevojshme në kuadër të Ligjit Nr. 03/L-054 për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës, për punimin e vulës së re të Agjencisë.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe obligimeve ligjore që tani ka Agjencia me miratimin e Ligjit të ri, si rezultat i diskutimeve paraprake në takimet e rregullta menaxheriale brenda Agjencisë, lidhur me ndryshimin e stemës konform mandatit të ri ligjor si dhe opsioneve të diskutuara, Drejtori i Agjencisë vendos për aprovimin e opsionit, të përcaktuar si në pikën 2 të dispozitivit të këtij Vendimi. Në kuadër të këtij Vendimi, vendoset njëkohësisht punimi i vulës së re, sipas Ligjit Nr. 03/L-054 për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës, në pajtim me emërtimin e ri ligjor dhe stemës së re, të përcaktuar si në pikën 1 dhe 2 të dispozitivit të këtij Vendimi.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është stema e re e Agjencisë.

Nga kjo që u theksua në arsyetim u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ylli BULESHKAJ
Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit



Vendimi i dërgohet:

- Të gjithë nëpunësve;
- Arkiva e APK



APK

AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION